



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 5-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 16.06.2026, në sallën nr. 2 në katin e tretë me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Alush Bikliqi, kryesues
2. Fitim Shala, anëtar
3. Gentianë Hoxhaj , anëtare
4. Hyra Bytyqi, anëtare
5. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
6. Yllëza Bedrolli, anëtare
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Maksut Gashi, anëtar,
9. Zoran Cirkovic, anëtar
10. Ollga Guciq, anëtare
- 11.Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Lidija Jovanovic ZKK
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Alush Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja 4-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa për Kornizën Afatmesme Buxhetore.
3. Raporti mujor i punës së Zyrës Komunale për Komunitete (ZKK-së)
4. Të ndryshme.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 4-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi tha se a ka vërejtje rreth ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e kaluara.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja 4-të e Komitetit për Komunitete dhe pas votimit konstatoi se Komiteti unanimisht aprovoi.

Meqë drejtori i buxhetit nuk është i pranishëm në këtë takim ne po vazhdojmë me pikën e radhës.

III

Raporti mujor i punës së Zyrës Komunale për Komunitete (ZKK-së)

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi ia kaloi fjalën Lidija Jovanovic , nga ZKKK e cila i njoftoi në pika të shkurta.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Zoran Cirkovic, tha se a ka ndonjë kritër për të përfituar këtë ndihme financiare në bazë të anëtarëve të familje apo ndonjë kritër tjetër.

Lidija Jovanovic, tha se bëhet një kërkesë ne ZKK për ndihmë financiare pastaj komisioni e shqyrton.

Fehmi Rexhepi, si ka mundësi që disa familje bëjnë kërkesë dhe nuk përfitojnë asnjëherë ndërsa disa tjera përfitojnë çdo vit.

Lidija Jovanovic, tha se ska shancë që e njëjta familje të përfitoj çdo vit pasi që është një komision që i shqyrton ankesat dhe në atë komision është edhe zyrtari i komunitetit ashkali.

Hyra Bytyçi, tha se ne si komiteti a kemi mundësi të ju ndihmojmë diçka si zyre?

Lidija Jovanovic, tha se kemi nevojë me na ndihmuar pasi që kemi shumë raste që kanë nevojë mirëpo s'kemi mjete të mjaftueshme, por me inicimin në kuvend apo ndonjë donator do të na ndihmonte.

Olga Guciç, tha se unë do ta ngris një shqetësim të cilin ju anëtarët jeni të njoftuar për dy motra në Janjevë që jetojnë me një shtëpi me kushte të vështira dhe gjendje të tmerrshme, vetëm deshta me ju njoftuare dhe një herë për rastin.

Alush Bikliqi, tha se edhe unë jam i njoftuar me rastin në fjalë dhe me të vërtet ka nevojë për mbështetje institucionale.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

IV

Të ndryshme

Zoran Cirkovic, tha se deshta të falënderoj institucionin e komunës po ashtu edhe kompanin për pastrimin e varrezave që kanë bërë një punë shumë të mirë.

Maksut Gashi, tha dhe unë do ta ngris një shqetësim të banorëve të komunitetit rom, për rrugën ku banoj e ku po vozitet me shpejtësi të madhe nga vozitësit ,po ashtu problemi edhe me trotinetët elektrik dhe kjo është bërë shumë shqetësuese. Tjetër shqetësim është uji i pijes që tani kemi filluar të mos kemi ujë të pijes dhe duhet të bëhet një zgjidhje.

Olga Guciq, tha po më të vërtet gjendja me ujë të pijes në Janjevë është shqetësuese.

Alush Bikliqi, tha sa i përket shqetësimit te Maksutit unë e kam ngrit edhe në KKSB këtë çështje, po ashtu tha se gjendja me ujë të pijes është duke e u bërë shqetësuese dhe duhet te ngritet edhe në kuvend ky shqetësim.

Shahadije Dragaçina, tha se unë e kam ngrit disa herë çështjen e ujit të pijes për Janjevë në Kuvend.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11'¹⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu
Zyrtar Ligjor

Kryesuesi i Komitetit

Alush Bikliqi